



Republika e Kosovës


Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Oraovac / Municipality of Oraovac

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



Nr. i prot. 1903 Br. prot. 19-10 20 22
RAHOVEC - ORAOVAC

RAPORT I PUNËS

TM3/2022



PËRMBAJTJA

HYRJE	3
Aktivitetet në periudhën: korrik, gusht, shtator.....	3
Aktivitetet tjera.....	6
PROJEKTET KAPITALE	7
Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore	7
Kanalet e kullimit të tokave bujqësore.....	7
PËRFUNDIM	8

HYRJE

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Kjo periudhë raportues fokusin kryesor e ka në fushatë e korrje-shirjeve

Aktivitetet në periudhën: korrik, gusht, shtator

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga korriku deri në shtator janë realizuar një mori aktivitete. Ndër më kryesoret do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Gjatë këtyre tre muajve pra korrik, gusht, shtator kryhen shërbime në kuadër të drejtorisë si: Vërtetim për fermer, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë, pagesa e participimit për mekanizëm bujqësor, nënshkrimi i kontratave me fermer etj.
- Kemi formuar shtabin për korrje-shirje 2022. Ky komision kishte për detyrë të përcjell procesin e korrje-shirjeve, koordinimin me pronarët e autokombajnave, si dhe raportimin në baza javore mbi ecurinë e kësaj fushate. Poashtu është hartuar raport përfundimtar i cili është dorëzuar në MBPZHR.
- Në fillim të muajit korrik është publikuar lista e përfituesve të mekanizmit bujqësor – Motokultivator me frez 7.5 kw. Janë nënshkruar kontratat me secilin fermer dhe është kryer edhe pjesa e participimit prej 20%. Po ashtu fermerët që kanë aplikuar dhe nuk kanë qenë përfitues kanë patur të drejtë për ankesë.
- Në kuadrë të programit të pagesave direkte, kemi pranuar dëshminë e sasisë së kilogramëve të grurit të dorëzuar në Qendrat Grumbulluese dhe Silose. Këto dëshmi janë dorëzuar në Ministrinë e BPZHR-së për Subvencionim me 0,03€/kg. Afati për pranim të këtyre dëshmime ka qenë deri më 2 shtator.
- Gjatë muajit korrik pra kryesisht me 20 korrik është hapur thirrja për aplikim për subvencione për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therrjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e parë 2022. Thirrja ka qenë e hapur deri më 19 gusht 2022. Ku gjatë kësaj periudhe janë kryer aplikimet e fermerëve të komunës sonë. Fermer aplikues janë 91, prej tyre 82 fermer blegtor për litrazhë të qumështit me gjithsej 2,149,382 litra dhe 20 fermer aplikues për viça me gjithsej 362 krerë.
- Kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme me zyrtarët e AZHB-së lidhur me aplikacionet dhe plotësimin e tyre për aplikimet e vitit 2022. Vazhdimisht kemi pranuar lista të fermerëve që

RAPORT I PUNËS | Korrik-Shtator 2022

nevojitet plotësim në kontrollin administrativë. Zyrtarët e bujqësisë i kanë kontaktuar fermerët, i kanë plotësuar dokumentet dhe të njëjtat i kanë dorëzuar në Ministri.

- Gjatë muajit gusht komisioni për ankesa ka bërë shqyrtimin e ankesave për mekanizmit bujqësor – Motokultivator me frez 7.5 kw, ku pastaj është publikuar lista e përfitueseve,



- Është bërë shpërndarja e mekanizmave bujqësorë, pasi janë kryer të gjitha procedurat e participimit dhe nënshkrimi i kontratave me secilin fermer:
 - Motokultivator me frezë - 27 copë,
 - Roto Kosa - 9 copë,
 - Grabuja me Traka me kardan - 1 copë,
 - Spërkatëse 500 L - 3 copë,
- Në fund të muajit gusht për shkak të kushteve të këqija atmosferike, pra kryesisht breshërit, në vendbanimet Ujz, Fshej, Gexhe, Malësi e Vogël fermerët e komunës sonë kanë pësuar dëme në prodhimet bujqësore. Është formuar komisioni për vlerësimin e dëmvë në bujqësi sipas kërkesës me nr. Prot 2925 të datës 15.08.22. anëtarët e komisionit kanë dalur në terren për të verifikuar dhe vlerësuar dëmet që u janë shkaktuar bujqëve. Dhe në fund është hartuar raport për dëmet e shkaktuara.
- Fillimi i muajit shtator është karakterizuar me dorëzimin e dëshmimeve të sasisë së grurit të dorëzuar në silose dhe qendra grumbulluese pasi që afati i fundit për aplikim ka qenë deri më 2 shtator.
- Gjatë këtij muaji është bërë edhe shqyrtimi i ankesave për mekanizëm bujqësorë (7 - Roto Kosa) si dhe shpërndarja e tyre po ashtu janë shpërndarë edhe mekanizmat tjerë, si :
 - 12 freza 1.6 m
 - 56 freza 1.8 m
 - 8 mulqere për hardhi
- Në mesin e muajit shtator, për shkak të kushteve jo të mira atmosferike, pra kryesisht shiut dhe vërshimeve me datë 17.09.22, i cili ka shkaktuar dëme në prodhimet bujqësore, kryesisht në specat, edhe në prodhimet tjera si lakra, kunguj, misër etj. janë formuar tre komisione të datës 19.09.2022 me numrat e protokollit: 2717, 2718, 2719 për vlerësimin e dëmeve në bujqësi, për të verifikuar dhe vlerësuar dëmet që u janë shkaktuar bujqëve.

RAPORT I PUNËS | Korrik-Shtator 2022

Anëtarët e këtyre komisioneve janë angazhuar në afat rekord për hartimin e një raporti profesional ku së bashku me kërkesën iu kemi drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës për kompensim të këtyre dëmeve.

Nga të dhënat e grumbulluara, të analizuara dhe të përlogaritura del se vlera totale e dëmeve është 1 milion e 735 mijë euro.

Nr.	Kultura	Vlera në €
1	<i>Dëmet në sektorin e perime-kulturës</i>	1,692,169.05 €
2	<i>Dëmet në sektorin e lavërtarisë</i>	15,086.50 €
3	<i>Dëmet në ushqimin e bagëtive të deponuar</i>	9,696.00 €
4	<i>Dëmet në infrastrukturën bujqësore</i>	8,397.20 €
5	<i>Dëmet në produkte të gatshme</i>	7,202.90 €
6	<i>Dëmet në sektorin e shpezëtarisë dhe bletarisë</i>	3,300.00 €
TOTAL		1,735,851.65



Aktivitetet tjera

Gjatë muajit korrik është mbajtur sesion informues në skemën e granteve, takimi është mbajtur në sallën e kuvendit ku janë prezentuar masat 1, 3 dhe 7, për fermerët që kishin interesim të aplikojnë.



Gjatë muajit korrik është përgatit dhe është hapur thirrja për OJQ-te që të aplikojnë rreth organizimit të "Festës së vjeljes së rrushit 7 shtatori – Hardhfest". Duke u bazuar në rregulloren në fuqi, thirrja ka qenë e hapur 15 ditë, deri më datë 23 korrik. Pas përfundimit të thirrjes komisioni i formuar me vendim të kryetarit ka bërë përzgjedhjen e OJQ-së fituese me të cilën kemi bashkëpunuar ngusht rreth organizimit të fesës së vjeljes së rrushit – Hardhfest.




Gjatë muajit gusht është bërë përgatitja e paramases për fillimin e procedurave për projektin " Ndërtimi i Objektivit – Depo Bujqësore"

PROJEKTET KAPITALE

Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore

Në projektin për rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve fushore, janë zhvilluar punimet në LOT 2 në vendbanimet Kramovik, Dobidol dhe Çifllak, Polluzhë, Gur i Kuq.



Në Lot 4 kemi intervenuar në disa pozicione nëpër vendbanime të komunës sonë, ndërsa Lot 1 dhe Lot 3 nuk janë zhvilluar punime.

Kanalet e kullimit të tokave bujqësore

OE që kanë kontratë me komunën e Rahovecit për projektin “Kanalet e Kullimit të Tokave Bujqësore” janë rikthyer në punishte duke zbatuar kontratën. Punimet janë zhvilluar në segmentin: Shtavica-Fortesë, segmentin në fshatin Çifllak, dhe segmenti në me stë fshatrave Fortesë – Celinë.



PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, është i vazhdueshëm. Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në terren duke takuar fermer në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermat e tyre. Poashtu nga fermerët kemi marr informata për pajisjet që iu nevoiten atyre, ku ne do të i përfshijmë në thirrjet për aplikim që do të hapen tremujorin e dytë.

Kemi krijuar raporte të mira me OJQ-të, me grupe të ndryshme, profesionist të fushave, me theks të veçant inxhinier të bujqësisë ku kemi pranuar këshilla, vërejtje dhe ide në mënyrë që të përmirësohemi dhe të zhvillojmë bujqësinë përditë e më mirë.

15.10.2022

Rahovec

 DREJTORI I DBPZHR-së
Berat Duraku